



## DEKLARATË PËR SHTYP

### NË LIDHJE ME MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT MIDIS ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË KOSOVËS (ZRRE), SHOQATËS KOMBËTARE TË KOMISIONERËVE RREGULLATORË TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE (NARUC)

#### DHE

### KOMISIONIT TË PENSILVANISË PËR NDËRMARRJE PUBLIKE (PUC)

Më 7 nëntor 2013, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Shoqata Kombëtare e Komisionerëve Rregullatorë të Ndërmarrjeve Publike (NARUC) dhe Komisioni i Pensilvanisë për Ndërmarrje Publike (PUC) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi (MM).

Ky Memorandum Mirëkuptimi shërben si bazë për aktivitetin e partneritet midis dy rregullatorëve dhe qëllimi i tij është të ilustroj rolet përkatëse të të gjitha palëve të përfshira në partneritet. Përmes shkëmbimeve, dy rregullatorët do të ndajnë përvojat, mësimet e nxjerra si dhe praktikatat më të mira, të cilat janë të vlefshme për Kosovën në mënyrë që të vazhdoj të krijoj dhe të zbatoj kornizën rregullative të qëndrueshme dhe të pavarur për të siguruar funksionim efikas, transparent dhe të qëndrueshëm të sektorit dhe të tregjeve të energjisë elektrike, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe investitorëve.

Ky partneritet financohet nga misioni i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Prishtinë dhe është pjesë e programit të NARUC-it për Rregullatorin dhe Sigurinë e Energjisë në Evropë dhe Euroazi.

Zëvendës Kryesuesi i PUC, Z. John F. Coleman Jr, dhe Z. Enver Halimi, Kryesues i Bordit të ZRRE-së, kanë shprehur mirënjohjen e tyre ndaj USAID-it për ofrimin e kësaj mundësie që të shkëmbejnë përvojat dhe idetë e tyre në lidhje me rregullimin e sektorit të energjisë.

Gjatë këtij aktiviteti ZRRE-ja do të kenë mundësi të punojë me komisionet anëtare të shumëfishta të NARUC-it, të cilat do të marrin pjesë në këtë partneritet ndërsa Komisioni i Pensilvanisë për Ndërmarrje Publike do të shërbejë si komision udhëheqës.

Për ZRRE-në ky është aktiviteti i dytë i partneritet që financohet nga USAID-i. Në tetor të vitit 2008 ishte filluar një aktivitet inagurues partneriteti ndërmjet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (ZRRE) dhe Komisionit të Tregtisë të Illinoisit (ICC) i cili ka vazhduar deri në qershor të vitit 2012. Ky program partneriteti ishte krijuar me qëllim që t'i mundësoj rregullatorit të Kosovës që të ketë qasje të gjerë në mjedisin rregullator të SHBA-ve si dhe t'i mundësoj ICC-së të ketë një kuptim më të mirë të kornizës rregullatore në rajonin e gjerë të Evropës Juglindore.